

Nue OROSHI, II. E djathta shqiptare vazhdon marshin për bërjen e Shqipërisë etnike

Organizuar nga Instituti i Historisë në Prishtinë në bashkëpunim me diasporën shqiptare, më 26-27 nëntor në Prizrenin e shumë besëlidhjeve shqiptare u mbajt sesioni shkencor „Forcat nacionaliste Shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore e deri në vitin 1950“.

Në këtë sesion shkencor morën pjesë 38 ligjërues nga të gjitha trojet etnike shqiptare.

Ky sesion që është vazhdimësi e akademisë së Hamburgut të 12-13 qershorit 2004 u mbajt me rastin e 100-vjetorit të lindjes së atdhetarit Xhafer Deva dhe 58-vjetorit të rënies heroike të kapidan dr. Mark Gjon Markut. Sesioni filloi punimet me himnin kombëtar e më pas këngëtarit dhe autori i tekstit „Thërret Prizreni mori Shkodër“, rapsodi Hamzë Llapqeva ngriti në këmbë të pranishmit në sallë. Ky solemnitet vazhdoi me deklamimin brilant të poezisë se Ernest Koliqit „Kënga e Kapidan Markut“ nga poetja kuksjane Ermira Spahiu. Më pas sesionin e shpalli të hapur Akademik Mark Krasniqi, ndërsa ligjëruesi i parë në këtë tubim shkencor, të parin të mbajtur në Kosovë pas 60 vitesh ishte Prof dr. Zekeria Cana në temën „Probleme metodologjike të studimit të nacionalizmit shqiptar“. Prof. Dr. Muhamet Shatri referoi në temën “Platforma kombëtare e Lëvizjes Nacional Demokratike Shqiptare“, kurse Akademik Mark Krasniqi evokoi kujtime për drejtuesit e shquar të LNDSH-së, si Gjon Serreqin, Ymer Berishën, Marie Shllakun dhe Nue Perllëshin.

Studiuesi Idriz Lamaj nga SHBA elaboroi gjerësisht kontributin e Xhafer Devës dhe të profesor Rexhep Krasniqit për ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës, ndërsa Emin Fazlia nga Gjermania foli mbi Rolin e profesor Ymer Berishës në Luftën për Shqipërinë etnike. Studiuesi i ri Nue Oroshi u përqendrua në Vendin dhe rolin që e zë Kapidan dr. Mark Gjon Marku në luftën për Shqipërinë etnike, kurse deputeti Fadil Geci foli për „Luftën e Drenicës dhe qëndresën e saj kundër riokupimit të Kosovës.“

Në seancën e pasdites ligjëruan prof dr. Nesim Vala në temën „Haki Taha simbol i heroizmit dhe i sakrificës kombëtare“, Xhafer Kabashi „Kontribut për ndriçimin e figurës atdhetare të Qazim Bllacës, Petrit Palushi nga Kukësi referoi në temën „Muharrem Bajraktari një nga drejtuesit e shquar të lëvizjes antikomuniste në Shqipërinë e Veriut, ndërsa publicisti Tom Mrijaj edhe kësaj radhe paraqiti shënime të reja për bijën e Shkodrës, martiren e Kosovës Marie Shllaku. Dr. Riza Sadiku paraqiti kumtesën „Xhemë Gostivari simbol i luftës për çlirim e bashkim kombëtar“, kurse veterani i nacionalizmit shqiptar Ibrahim Metaj kishte sjellë nga Suedia studimin e tij „Kontributi dhe veprimtaria e nacionalistëve në Istog e rrethinë“. Studiuesi Jetish Kadishani sërish u përqendrua „Në luftën e Çetës së Uk

Sadikut kundër ripushtimit të trojeve etnike shqiptare“, ndërsa historiani Prekë Gjeta foli për figurën kombëtare të Nue Perllshiti, duke e e vlerësuar atë si luftëtar të shquar kundër ripushtimit serb.

Edhe dita e dytë e këtij tubimi shkencor ishte shumë e frytshme. Me punimet e tyre e prezantuan Dr. Islam Lauka, i cili foli për „Vlerësimet e Dr. Nina Smimovës për Shqipërinë në Luftën e Dytë Botërore, Fran Camaj për Gjelosh Lulin si figurë e shquar e lëvizjes antikomuniste, mandej Prof. dr. Fehmi Rexhepi për Esat Berishën si intelektual dhe luftëtar i vendosur për Shqipërinë etnike, Rexhep Kastrati foli për programet e partive nacionaliste shqiptare në këtë periudhë kohore, ndërsa Mr. Abdurrahman Zylfiu për kontributin e Ibrahim Kelmendit, të cilin e vlerësoi si nacionalist të shquar të Luginës së Preshevës. Fazli Hajrizi Ligjëroi mbi Rexhep Mitrovicën si sinonim të Shqipërisë etnike, Dr. Xhovalin Quni në temën Veprimtaria antikomuniste e Myzafer dhe Arshi Pipës, ndërsa Dr. Lush Culaj u përqendrua në kontributin e Zef Gjiodës, i cili e shkriu një jetë në shërbim të kombit. Avni Billalli nga Gjermania u përqendrua në qëndresën kundër ripushtimit serbokomunist në Shalë të Bajgorës, kurse studiuesi Adem Ajvazi foli mbi Lëvizjen Nacional Demokratike në Llap, derisa veterani i nacionalizmës shqiptare Shefqet Kelmendi evokoi disa kujtime të tija mbi atë Bernard Llupin dhe veprimtarinë atdhetare të tij. Mr. Mehmet Gjoshaj u ndal tek anatemi i historisë kombëtare në kohën e regjimit komunist, kurse studiuesi i ri Besim Morina foli mbi rolin e Mehmet Gradicës në Luftën e Drenicës, e Mr. Muharrem Gashi mbi figurën e shquar të kombit patër Anton Harapin.

Edhe studiuesit e tjerë, që për shkaqe personale nuk kishin mundur të mermin pjesë në këtë sesion kishin dërguar kumtesat e veta. Në kumtesën e Prof. dr. Rome Gurakuqit bëhej fjalë për kontributin e Ernest Koliqit në Bllokun Kombëtar Independent, e Dr. Muharrem Dezhgiu kishte dërguar temën Pozicioni Ushtarak e politik i forcave Nacionaliste në Shqipërinë Veriore gjatë Luftës së Dytë Botërore, ndërsa Dr. Ramiz Abdyli për nacionalizmen shqiptarë në Maqedoni gjatë Luftës së Dytë Botërore, Muharrem Canaj nga Çamëria temën për qëndresën çame gjatë Luftës së Dytë Botërore e shumë tema të tjera interesante. Shumë interesante në këtë sesion shkencor ishin edhe diskutimet në të cilat morën pjesë shumë pjesëmarrës të gjallë të atyre kohërave, si atdhetarët Mark Avdyli-Ndreja, Smajl Silamniku, Shefqet Kelmendi, Viktor Gashi, Hafiz Jusuf Azemi, Ajet Rushiti e shumë të tjerë që ngjallnin emocione të papërshkrueshme pas plot 60 vjetësh harrese të këtyre figurave kombëtare të Shqipërisë etnike.

Më pas Prof. dr. Muhamet Shatri, sekretar shkencor i Institutit të Historisë të Prishtinës, mbylli punimet e këtij sesiioni shkencor, të parit pas 60 vjetësh të mbajtur në Prizren me premtimin që ky marsh i Shqipërisë etnike të vazhdohet në Shkoder, Klinë, Shkup, Tuz, Tiranë, Prishtinë, Preshevë e Janinë.

INSTITUTI I HISTORISË I PRISHTINË

KOSOVA

26

2004

Redaktor gjuhësor

Hysen Kadriu

Rezimetë i përktheu

Avni Spahiu

Përgatitja kompjuterike

Valon J. Fetahu

Korrektor

Nexhmije Sejdiu

Tirazhi: 500 copë

Madhësia: 29 tabakë shtypi

Formati 16 x 24 cm

U shtyp në shtypshkronjën KGT - Prishtinë

